

AKTI THEMELUES

I SHOQËRISË TREGTARE PRIVATE

"BANI 2G" SHPK

Sot me date 06.01.2025 u mblohdhen ortaket :

1 – Gramos Bani i datelindjes 04.03.1972, lindur ne Fier, banues në Mali i Qerimit 01690058, Nd. 10, H. 1, Zharres 9317, Patos, Fier, identifikuar me leternjoftimin ID karte identiteti me numer personal H20304024P.

2 – Grenald Bani i datelindjes 10.11.1997, lindur ne Fier, banues në Rruga Hamdi Sina, Pallati Primavera, Njesia 1, Tirane, identifikuar me leternjoftimin pasaporte me numer personal J71110029T.

mbështetur në Ligjin **Nr. 9723**, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" i ndryshuar dhe në ligjin **Nr. 9901** datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, sot me datë 06.01.2025 krijojme shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**Bani 2G**" shpk, me aktin themelues të saj si vijon:

NENI 1

FORMIMI

Formohet shoqëria private e quajtur "**Bani 2G**" sh.p.k. Shoqëria do t'i nënshtrohet legjislaconit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do t'i nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë, dega.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaket themelues.

NENI 2

SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë tregtare private "**Bani 2G**" sh.p.k. do të jetë: Rruga Hamdi Sina, Zona Kadastrale 3266, Pallati Primavera, Pasuria me numer Nr. 161/3-D1, Liqeni i Thate, Tiranë. Ajo mund të çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësie dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratimin e organeve kompetente edhe jashtë vendit.

Shoqëria mund të ndryshoj selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e ortakëve të saj.



NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktivitetave që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose lashtë territorit të Republikës së Shqiperisë, duke u fokusuar kryesisht në:

Shërbime dhe Punime si: Suvatim, stukim, patinim dhe lyerje ndërtesash brenda jashtë saj, si dhe lyerje konstruksionesh metalike. Punime me dru dhe materiale druri, gips, elektrike, elektronike, hidraulike, hidrotekniche, mekanike, metalike, shtrim pllakash dhe parketi, punime xhami, fasade, dritare duralumini, dritare druri, dritare metalike, dritare xhami etj. Tregtimi dhe dhene me qera te skelave, strukturave skelerike, strukturave per fasadave te ndertimit etj. Tregtimi i produkteve bujqësore, blegtore, shtazore, mishit të freskët dhe nënproduktet e tij edhe në formën e ngrirë të tyre, bulmeti, ushqimore, akullore, cokollata, detegjente, kozmetikë, artikuj të ndryshëm industrial. Krijimin e njësive tregtare të veçanta apo rrjet të njësive tregtare bazuar në shitjen me vetshërbim. Përpunimin, paketimin, rishitjen e të gjitha produkteve të përmendura më sipër. Realizimi i transportit të mallrave dhe produkteve për vete ose për të tretë.

NENI 4

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i Shoqërisë tregtare private "**Bani 2G**" sh.p.k. do të jetë **100 000** Lekë (Njëqind mijë) dhe do të përbëhet nga kuotat e ortakeve themelues të shoqërisë. Kapitali përbëhet nga 2 kuota te barabarta dhe vlera nominale e një kuote është e barabartë me **50 000** Lekë (Pesëdhjetë mijë). Kapitali Themeltar filletar mund të shtohet sipas vendimit të ortakeve themelues. Kapitali është tërësisht I shlyeshëm dhe I nënshkrueshëm.

Ortaket duhet të bëjnë përpjekje përritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajë sekretin e saj dhe të mos dëmtojnë interesat e personave të tjera dhe të shoqërisë.

NENI 5


KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkaku.

NENI 6

DREJTIM I SHOQËRISË

Shoqëria do të drejtohet nga 1 administrator Zt. Gramos Bani, i cili është përfaques ligjor i saj. Afati i emërimit të administratorit është për një periudhë kohore prej 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.



NENI 7

Të ardhurat neto të shoqërisë I takojnë ortakeve themelues të shoqërisë.

NENI 8

Ortaket themelues kane të drejtë të emërtojë dhe administrator të tjerë të vlerave materiale të shoqërisë. Ata kane të drejtë të caktojnë financier, likuidator për problemet e shoqërisë, si dhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të shoqërisë.

NENI 9

Shoqëria ka vulën e saj në madhësi të zakonshme ne forme rrrethore, me tekstin " **BANI 2G** " shpk, Numrin e NUIS dhe adresa Tirane.

NENI 10

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të sigurojë mjetet e nevojshme dhe do të bashkëpunoj me persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj.

NENI 11

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit, në përputhje me legjisacionin shqiptar në fuqi dhe vecanërisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.


Ky akt themelimi përpilohet në tre kopje me vlerë të barabartë, nga të cilat njëra depozitohet online në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dhe mbahet në dokumentat e shoqërisë tregtare " **Bani 2G** " sh.p.k. dhe 2 kopje per secilin ortak themelues.

Akti I themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët themelues.

ORTAKET THEMELUES TË SHOQËRISË

"**BANI 2G** " SH.P.K.

GRAMOS BANI



GRENALD BANI

